

VENDIM
Nr.1036, datë 14.10.2009

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.891, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN E NJË SIPËRFAQEJE, PRONË SHTETËRORE, NË
FONDIN E KOMPENSIMIT FIZIK DHE VËNIEN E SAJ NË DISPOZICION TË
AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë“, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Shfuqizimin e vendimit nr.891, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e një sipërfaqeje, pronë shtetërore, në fondin e kompensimit fizik dhe vënien e saj në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.

2.Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, bashkia Tiranë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha